



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 228/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, lagjja Kalabria, rr. “Rexhep Krasniqi”, kundër debitorit “M...”, SH.P.K, NRF: ..., me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr 2549/19 të datës 29.08.2019 të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 02.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “M...”, sh.p.k, me seli në Prishtinë, NRF:, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr 2549/19 të datës 29.08.2019, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi.

II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr 2549/19 të datës 29.08.2019, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi.

A r s y e t i m

Kreditori, Dogana e Kosovës ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit “M...”, sh.p.k , për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbartues – Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje, i datës 16.05.2019, i formës së prerë me datë 22.06.2019 dhe i ekzekutueshëm me datë 22.07.2019, me të cilin debitori është obliguar që kreditorit në emër të gjobës për kundërvajtje doganore t’ia paguaj shumën prej 5,000.00 € (pesë mijë euro), pas pranimit të Aktvendimit, në xhirollogarinë e Doganës së Kosovës – Sektorit i Kontrollës Pas Importuese.

Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës, me datë 29.08.2019, ka lëshuar Urdhrit Përmbartimor P.nr 2549/19, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje , i datës 16.05.2019.

Kreditori në propozimin për përmbaram të datës 29.08.2019, ka kërkuar që të detyrohet debitori “M...”, sh.p.k , që të ia paguaj kreditorit Dogana e Kosovës, shumë prej 5,000.00€ (pesë mijë euro) nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaramore dhe shpenzimet tjera të krijuara, sipas Udhëzimit Administrativ MD.NR.06/2014.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, me të cilin e ka kundërshtuar si të pa bazuar urdhrin përmbaramor, duke shtuar se ka pasur vërejtje në procedurën me të cilën i është konstatuar sasia e mallit të importuar duke theksuar se në dokumentacionin e paraqitur nga ana e debitorit është konstatuar mjaft qartë sasia e mallit të importuar nga Holanda, ndërsa me rastin e verifikimit të sasisë së mallit nga personat kompetent të doganës në pikën kufitare të dheut të bardhe nuk është bërë kontrolli detal i mallit të importuar, por vetëm është bërë shtimi i mallit në mënyre fiktive dhe paushalle. I ka propozuar gjykatës që të hudhet poshtë urdhri për përmbaram.

Kreditori me përgjigje në prapësim i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit në prapësim si të pabazuara, duke theksuar se në vështrim të nenit 22 të LPP-së, janë përcaktuar cilat vendime janë tituj përmbaramor, dhe se propozimi për përmbaram i parashtruar nga ana e kreditorit i plotëson kushtet sipas dispozitave të nenit 23 par.2, nenit 24 pika.1 të LPP-së, duke i propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe urdhri përmbaramor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaramore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata konstaton se organi përmbaramor ka lejuar përmbaramin mbështetur në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbaramor e cakton, përkatësisht e zbaton përmbaramin vetëm në bazë të dokumentit përmbaramor (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka vlerësuar dokumentin përmbaramor Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje ..., i datës 16.05.2019, në bazë të të cilit përmbaramor privat ka lejuar

përmbarimin dhe gjeti si i njëjti është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla, bazuar në nenin 22 paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 të LPP-së. Po ashtu Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje 03.1.7-2019-556-3, i datës 16.05.2019, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje, i datës 16.05.2019, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafi 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*, ngase Aktvendimi i Doganës së Kosovës – Sektori për kundërvajtje, i datës 16.05.2019, është bërë i formës së prerë me datë 22.06.2019 dhe i ekzekutueshëm me datë 22.07.2019.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarues mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në 73 të LPP-së dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.228/22, datë 02.09.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,

nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,

në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.